

NJOFTIM

Drejtuar: Agjencise Kombetare te Mjedisit

Lenda: Kerkese per zhvillimin e procedures se degjeses me publikun

Shoqeria "BELLO TRIS" SH.P.K njofton Agjencine Kombetare te Mjedisit per zhvillimin e procedures se informimit te publikut per aplikimin per leje mjedisi te ti pit B per instalimin:

Akuakulturë intensive. ID 8.1 “Rritje intensive e peshqve”, me vendndodhje: “Kepi i Kallogjerit, Karaburun, Njësia Administrative Orikum, Bashkia Orikum, Qarku Vlorë”.

Ky njoftim hartohet Referuar VKM 419, date 25.06. 2014, Per miratimin e kerkesave te posacme per shqyrtimin e kerkesave per leje mjedisi te ti pave A, B dhe C, per transferimin e lejeve nga nje subjekt te tjetri, te kushteve per lejet respektive te mjedisit, si dhe rregullave te hollesishme per shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri ne leshimin e ketyre lejeve nga QKB-ja" te ndryshuar, kreu VI "Informimi dhe pjesemarrja e publikut per aplikimin per leje mjedisi te tipit A dhe B", bashkangjitur gjeni dokumentacionin e kerkuar, sipas pikes 2 te ketij kreu:

- Informacion nëse kërkesa do të jetë për **“Aplikim për leje mjedisi të tipit A ose të tipit B”** apo **“Aplikim për ndryshim thelbësor në kushtet e lejes së mjedisit të tipit A ose të tipit B”**.
- Të dhënat e ekstraktit të QKR-së;
- Adresën e vendndodhjes së instalimit;
- Përshkrimin e veprimtarisë që parashikohet të zhvillohet në instalim;
- Përmbledhjen joteknike të raportit të vlerësimit të ndikimit në mjedis në nivel kombëtar ose ndërkufitar, kur kërkohet procedura e vnm-së;
- Konsultimet ndërkufitare, kur kërkohet sipas legjislacionit në fuqi;
- Autoritetin vendimmarrës për dhënien e aktit të miratimit të lejes së mjedisit, procedurat dhe afatet që do të ndiqen;
- Adresën e AKM-së, ku publiku mund të dërgojë komentet dhe sugjerimet e tij, me shkrim apo në formë elektronike, brenda 20 (njëzet) ditëve nga data e njoftimit;

- Kërkesa për vendosjen në funksionim të instalimit “Rritje intensive e peshqve” është për aplikim **per leje te re mjedisore te tipi B**, sipas Shtojces 1, të Ligjit Nr. 52/2020, datë 30.04.2020 Për disa ndryshime në ligjin nr. 10448, datë 14.7.2011 "Për lejet e mjedisit" të ndryshuar",

- **Akuakulturë intensive:**
ID 8.1 “Rritje intensive e peshqve”

- Të dhënat e ekstraktit të QKR-së;



**EKSTRAKT I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E
SUBJEKTIT “SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR”**

GJENDJA E REGJISTRIMIT

1. Numri unik i identifikimit të subjektit (NUIS)	K67220202D	
2. Data e Regjistrimit	20/10/2006	
3. Emri i Subjektit	BELLO TRIS	
4. Forma ligjore	SHPK	
5. Data e themelimit	13/01/2006	
6. Kohëzgjatja	Nga: 13/01/2006 31/12/2020	
7. Zyra qendrore e shoqërisë në Shqipëri	Vlore Orikum ORIKUM Orikum, Karaburun, Lagjja Karaburun, Gjiri Raguzes (Rezervat Peshku)	
8. Kapitali	100.000,00	
8.1 Numri i përgjithshëm i kuotave	100,00	
9. Objekti i aktivitetit	Kultivimi dhe tregtimi i peshkut të ujërave të kripura. Tregtimi me shumicë dhe pakicë të artikujve të ndryshëm industrialë dhe ushqimorë, materialeve të ndërtimit, hidrosanitare, elektrike, elektroshtepiake, pjesëve të këmbimit të automjeteve, pajisjeve të zyrave; import - eksporti i tyre. Tregtim me pakicë karburanti dhe vajra lubrifikante . Aktivitet në fushën e shërbimeve; agjensi shërbimesh dhe agjensi turistike; servis për mjete mekanike dhe bujqësore; aktivitet në fushën e transportit , për vetë dhe për llogari të tjetërve; transporte nacionale dhe Internacionale; transport maillra e pasagjere. hapje bar - restoranteve ,picerive, aktivitet në fushën e hoteierisë.	
10. Administratori/et	Markeljan Paja	
10.1 Afati i emërimit	Nga: 06/04/2023	Deri: 05/04/2028
11. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore		
11.1 Kufizimet e kompetencave (nëse ka)		
12. Ortakët	Markeljan Paja	
12.1 Vlera e kapitalit	Para: 100.000,00	Natyre:
12.2 Numri i pjesëve	100,00	
12.3 Pjesëmarrja në përqindje (%)	100,00	
- Të përfaqësuarit, (Plotësohet vetëm nëse		


<i>zotëron kuotën si përfaqësues)</i>	
13. Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit	Vlore Orkum DUKAT FUSHE Rruga Nacionale Vlore-Himare, Fushe Dukat, Objekt 2-katesh nr.1 (Paketimi edhe Zyra).
14. Të dhëna që njoftohen vullnetarisht	Emri Tregtar: BELLO TRIS E-Mail: ervinad3@gmail.com Telefon: 0696952777 0694544925
15. Statusi:	Aktiv

Datë: 21/03/2025

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi
(i nëpunësit të sportelit)

Kopje nga Web

▪ Adresën e vendndodhjes së instalimit;

Emri i instalimit/impianit ¹	Akuakulturë intensive																		
Adresa ku ndodhet apo do te ngrihet instalimi/impianiti	Kepi i Kallogjerit, Karaburun, Njësia Administrative Orikum, Bashkia Orikum, Qarku Vlorë																		
Koordinatat e vendit sipas Sistemit Koordinativ GAUS KRUGE: 1942_GK_ZONE_4 	<table border="1"> <thead> <tr> <th colspan="3">Koordinatat e sipërfaqes se aktivitetit sistemin Universal ETRS89</th> </tr> <tr> <th>Pika</th> <th>Koordinatat Lindje</th> <th>Koordinatat Veri</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>1</td> <td>19°25' 8.07"E</td> <td>40°20'28.15"N</td> </tr> <tr> <td>2</td> <td>19°25'10.97"E</td> <td>40°20'48.47"N</td> </tr> <tr> <td>3</td> <td>19°25'24.41"E</td> <td>40°20'47.50"N</td> </tr> <tr> <td>4</td> <td>19°25'21.22"E</td> <td>40°20'27.06"N</td> </tr> </tbody> </table>	Koordinatat e sipërfaqes se aktivitetit sistemin Universal ETRS89			Pika	Koordinatat Lindje	Koordinatat Veri	1	19°25' 8.07"E	40°20'28.15"N	2	19°25'10.97"E	40°20'48.47"N	3	19°25'24.41"E	40°20'47.50"N	4	19°25'21.22"E	40°20'27.06"N
	Koordinatat e sipërfaqes se aktivitetit sistemin Universal ETRS89																		
Pika	Koordinatat Lindje	Koordinatat Veri																	
1	19°25' 8.07"E	40°20'28.15"N																	
2	19°25'10.97"E	40°20'48.47"N																	
3	19°25'24.41"E	40°20'47.50"N																	
4	19°25'21.22"E	40°20'27.06"N																	
	<table border="1"> <thead> <tr> <th colspan="3">Koordinatat e sipërfaqes se aktivitetit në sistemin Gaus-Kruger</th> </tr> <tr> <th>Pika</th> <th>Y</th> <th>X</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>1</td> <td>4365786.383</td> <td>4468740.408</td> </tr> <tr> <td>2</td> <td>4365866.029</td> <td>4469365.995</td> </tr> <tr> <td>3</td> <td>4366182.703</td> <td>4469330.414</td> </tr> <tr> <td>4</td> <td>4366096.172</td> <td>4468701.245</td> </tr> </tbody> </table>	Koordinatat e sipërfaqes se aktivitetit në sistemin Gaus-Kruger			Pika	Y	X	1	4365786.383	4468740.408	2	4365866.029	4469365.995	3	4366182.703	4469330.414	4	4366096.172	4468701.245
Koordinatat e sipërfaqes se aktivitetit në sistemin Gaus-Kruger																			
Pika	Y	X																	
1	4365786.383	4468740.408																	
2	4365866.029	4469365.995																	
3	4366182.703	4469330.414																	
4	4366096.172	4468701.245																	
Kategorite e aktiviteteve/veprimtarive industriale te cilat duhet te kerkojne leje mjedisi ²	ID 8.1 “Rritje intensive e peshqve”																		
Kapaciteti i projektuar	-Kapaciteti i prodhimit është i barabartë me 1000 ton/vit ose më pak se kaq, por gjithsesi më i madh se 100 tonë peshk/vit. (Kapacitet kufi per te gjitha Lejet B) -18 Kosha lundrues -Sipërfaqja e burimit ujqor qe ze aktiviteti 20ha																		

▪ **Përshkrimin e veprimtarisë që parashikohet të zhvillohet në instalim;**

Instalimet për “Rritjen intensive të peshkut”, të shoqërisë "BELLO TRIS" Sh.p.k janë të pozicionuar në adresën; “Kepi i Kallogjerit, Karaburun, Njësia Administrative Oriku, Bashkia Oriku, Qarku Vlorë”.

Aktiviteti në vlerësim është instalimi i disa koshave lundrues me qëllim rritjen intensive të peshkut (llojet Koce dhe Levrek). Projekti zhvillohet në vijën bregdetare të Detit Jon, rreth 890m larg vijës bregdetare në vendin e quajtur “Kepi i Kallogjerit, Karaburun”, në territorin administrativ të Bashkisë Oriku, Prefektura Vlorë.

Te dhënat teknike të objektit në mënyrë të përmbledhur paraqiten si më poshtë:

Sipërfaqja_{ujore}=**20ha**, (Kategoria 01 e ZPA për peshqit, në zonën bregdetare Vlorë ZPA)

Distanca nga bregu: **L=890m (Pika më e afërt)**

Emërtimi i zonës: **Kepi i Kallogjerit, Karaburun.**

Numri i koshave: **18 kosha lundrues**

Përshkrimi i vendit dhe i veprimtarisë ku zhvillohet instalimi.

Zona ku do të zhvillohet veprimtaria e mbareshtimit të peshkut është e organizuar në atë mënyrë që të plotësojë të gjithë rregulloren e Agjencisë Rajonale të Mjedisit. Gjiri dhe pellgu detar ku do të vendosen pajisjet kanë një sipërfaqe prej 20ha, të rrethuara nga një sistem koshash lundruese. Për sa i përket thellesisë së detit, vaskat lundruese do të vendosen në një thellesë që është e mjaftueshme për depertimin e rrymave ujore.

Infrastruktura e nevojshme detare përfshin;

- **Koshat** për rritje dhe ruajtjen e peshkut
- **Rrjeta** të madhësive të ndryshme që do të përdoren për në koshat e kultivimit të peshkut sipas madhësisë e diametrit të nevojshëm në çdo fazë.
- **Bova dhe tapa**, të cilat shërbejnë si pajisje sinjalizuese
- **Spiranca** për fiksimin e koshave dhe strukturave ndilunese në mënyrë që të bëhet një ankorim sa më i mirë dhe i qëndrueshëm i këtyre strukturave.
- **Litar (diametër 40, 50, etj)** që do të nevojiten për fiksimin e koshave dhe rrjetave.
- **Platforme për vjeljen e peshkut** Platforme të projektuar për vjeljen e peshkut e pajisur me rrampe për vendosjen e strukturave për vjeljen e peshkut e pajisur dhe me vincë të elementeve të tjera ndihmues në këtë proces.
- **Platforme për hedhjen e ushqimit** Një platforme e automatizuar për hedhjen e ushqimit me efikasitet dhe kohë të shkurtuar në koshat e kultivimit të peshkut.
- **Mjete të transportit ujor:** tre motorra uji janë parashikuar në funksion të fermës për lëvizje të shpejta dhe të vazhdueshme për nevojat e ndryshme
- **Sisteme matëse të ujit:** Sistemet e kontrollit të ujit për mbajtjen e parametërve të ujit si temperatura, niveli dhe oksigjeni dhe pH janë thelbësore për mirëqenien e peshkut.
- **Sisteme pastrimit të ujit:** Pajisjet për pastërtinë të ujit dhe sisteme filtrimi për heqjen e mbetjeve të ushqimit dhe plehrave janë të domosdoshme për të mbajtur cilësinë e ujit të përshtatshme për rritjen e peshkut.

- **Sisteme te Kontrollit te Parasiteve dhe Sjelljes se Peshkut:** Pajisje dhe teknologji per te kontrolluar dhe parandaluar infeksionet nga parazite dhe semundjet, si dhe per te monitoruar sjelljen dhe shendetin e peshkut.
- **Personel me Ekspertize:** Nje ekip i trajnuar mire per menaxhimin e fermes dhe per kujdesin ndaj peshkut eshte thelbesor per suksesin e akuakultures se peshkut ne dete.

Vendodhja;

Kepi i Kallogjerit, Karaburun, Bashkia Orikum, Qarku Vlore.

Koordinatat e sipërfaqes se aktivitetit sistemin Universal ETRS89		
	Koordinatat Veri	Koordinatat Lindje
Pika Nr. 1	40°20'28.15"N	19°25' 8.07"E
Pika Nr. 2	40°20'48.47"N	19°25'10.97"E
Pika Nr. 3	40°20'47.50"N	19°25'24.41"E
Pika Nr. 4	40°20'27.06"N	19°25'21.22"E
Sipërfaqja ujore= 20ha,		

Koordinatat e sipërfaqes se aktivitetit në sistemin Gaus-Kruger		
	Koordinatat Y	Koordinatat X
Pika Nr. 1	4365786.383	4468740.408
Pika Nr. 2	4365866.029	4469365.995
Pika Nr. 3	4366182.703	4469330.414
Pika Nr. 4	4366096.172	4468701.245
Sipërfaqja ujore= 20ha,		

Pamje satelitore te zones ku zhvillohet aktiviteti





Përshkrimi i aktivitetit të propozuar

Shoqeria “BELLO-TRIS”, ka adoptuar teknologjite më të avancuar të kultivimit intensiv të peshkut në det, për krijimin e një ferme moderne me fokus në kultivimin e koces dhe levrekut. Në sipërfaqen e marrë me qira prej 20ha, ku do të instalohen 18 kosha me diametër 19m dhe me një thellesi rrjete prej 14m që kanë një volum të përafërt prej 1327m³. Koshat janë të ndërtuara nga materiale të qëndrueshme dhe të rezistent ndaj kushteve të vështira detare. Ato janë të vendosura në 3 rreshta me nga 6 kosha të fiksuara në bazin e detit me spiranca dhe të shtanguara midis tyre. Koshat do të jenë të ankoruara mirë për të siguruar qëndrueshmërinë dhe mbrojtjen nga stuhitë dhe rrymat e forta detare.

Në ndërtimin nga këto struktura do të kemi mundësinë të akomodojmë nga 130 mijë deri në 142 mijë individ (në varësi të firove) të cilët në harkun e një viti pasi të kenë arritur peshën e 0,35kg (si kërkohet nga tregu) do të përbejnë në total rreth 40,000 kg për çdo kosh. Për të parashikim të përafërta në vitin e tretë ferma arrin kapacitetin e 720ton në një kultivim intensiv dhe të qëndrueshëm.

Rasati që popullon Instalimin

Duke konsideruar kushtet që ofron vendi, me qëllim ofrimin e një çilesie të lartë në treg, rasati sigurohet nëpërmjet importimit nga Greqia dhe Italia, ku inkubohet nga firma serioze dhe të certifikuar për këto produkte, ku në një proces strikt transferohen nga inkuboret në koshat e vendosura në det. Transferimi kryhet me kujdes për të minimizuar stresin dhe për të siguruar që larvat të përshatën me kushtet e reja. Për vendosjen e rastatit në kosha janë parashikuar rrjeta speciale për rasatin të cilat janë të një diametri të tillë për të mbajtur peshkun e vogël të gramaturës nga 3-5gr.

Brenda koshave, peshqit rriten ne nje mjedis te mbrojtur ku kane hapesire te mjaftueshme per te notuar dhe zhvilluar. Ushqimi i peshkut eshte nje aspekt kyç per ne dhe teknologjia jone e ushqimit siguron nje diete te balancuar qe nxit rritjen e shpejte dhe te shendetshme te peshkut.

Ushqimi i rasatit Koc-Levrek eshte eshte nje nga prioritete dhe shoqerise. Ushqimi ka nje rendesi te vecante jo vetem ne nxjerrjen e nje produkti cilesor ne treg por edhe ne shendetin e rasatit, e per rrjedhoje edhe per te gjithë ciklin e prodhimit. Furnizuesi me ushqim sigurohet nepermjet importimit, pasi vleresojme se arrihet raporti me i larte i mundeshem i faktoreve cmim-cilesi. Perberesit kryesore te ketij ushqimi qe perdoret ne impiant, jane te nje cilesie te larte e cila kontrollohet periodikisht per te garantuar ne produkt "BIO".

Pajisjet teknologjike monitorojne parametrat e ujit, si temperatura, niveli i oksigjenit, pH dhe permbajtja e amoniakut, duke siguruar qe kushtet e ujit te jene gjithmone optimale per peshqit. Teknologjia perdoret gjithashtu per te monitoruar shendetin e peshqve ne menyre te vazhdueshme. Kamera dhe sensore te vendosur ne kosha ndihmojne ne vzhgimin e peshqve dhe identifikimin e shenjave te semundjeve ose stresit. Kjo na mundeson nderhyrje te shpejta dhe trajtime te pershtatshme per te parandaluar perhapjen e semundjeve.

Ne fazen e vjeljes, peshqit nxirren nga koshat duke perdorur pajisje speciale qe minimizojne tresin dhe demtimet. Teknologjia jone e perpunimit pas vjeljes perfshin sisteme te avancuara per pastrimin, paketimin dhe ruajtjen e peshkut ne kushte higjenike dhe te ftohta, duke ruajtur cilesine e larte te produktit deri sa te arrije ne treg.

Proces i prodhimit

Ferma e rritjes intensive e akuakultures do te kete nje kapacitet total prodhimi prej 720 tonesh. Zona ku do te zhvillohet veprimtaria e mbareshtimit te peshkut eshte e organizuar ne ate menyre qe te plotesoje te gjithë rregulloren e Agjencise Rajonale te Mjedisit. Gjiri dhe pellgu detar ku do te vendosen pajisjet kane nje siperfaqe prej 20ha, te rrethuara nga nje sistem koshash lundruese. Per sa i perket thellesise se detit, vaskat lundruese do te vendosen ne nje thellesi qe eshte e mjaftueshme per depertimin e rrymave ujore.

Ne vendin ku do te vendosen koshat lundruese, si fillim do te behet analiza e ujit te detit; do te percaktohen dhe maten temperaturat e ujit dhe sasia e oksigjenit ne uje per nje ecuri sa me te mire te rritjes se peshkut. Trajtimi i peshqve me ushqim te kontrolluar do te vazhdoje derisa te arrij ne permasat e kerkuara nga kerkesa me e larte e tregut. Ky eshte nje proces qe kompania ka pervojte te gjate dhe te suksesshme, duke shfrytezuar te gjithë kapacitetin prodhues dhe duke rrundesuar rritjen e peshkut sipas pritshmerive, pa regjistruar asnje cikël peshku me cilesi te ulet.

Per te arritur kapacitetin prodhues dhe sasine e peshkut te prodhuar, kompania fillimisht duhet te rrise kapacitetet e prodhimit dhe infrastrukturen.

Si e tille do te nevojiten pajisje shtese per mbareshtimin e peshkut. Investimi total do te bazohet ne pervojten e brendshme qe kompania ka per nje peridhe 10 vjacare dhe vecanerisht ne pervojten e jashtme te sjelle nga furnitoret italiane dhe greke, te cilet jane eksperte kryesore ne kete sektor. Do te nevojiten rrjeta rezerve shtese per t'u zevendesuar here pas here ne varesi te fazave te rritjes se peshkut.

Per te siguruar fermen nga qarkullimi i mjeteve lundruese si gjate dites ashtu edhe gjate nates, do te vendosen bova dhe tapa, te cilat sherbejne si pajisje sinjalizuese, si dhe nje sistem elektrik qe mundeson ndricim te vazhdueshem dhe te mjaftueshem.

Ushqimi do te transportohet me forklift dhe do te shperndahet me mekanizma te tjere te cilet barten nga nje platforme me motor. Ne kete menyre kompania do te permiresoje ndjeshem procesin e te ushqyerit duke investuar ne sistemin e distributorit te ushqimit.

Investimi ne kete infrastrukture pritet te nise menjehere ne Nentor 2024 dhe do te shfrytëzohet per nje periudhe te pakten 2 vjecare. Kapaciteti prodhues per nje vaske eshte 40ton peshk me nje totale prej 18 kafazesh me qellim prodhimin e 720ton peshk.


Peshku i fresket do te vazhdoje te vilet nga ferma me kerkese te klienteve, pasi te jete paketuar ne kuti te specializuara me akull ne ambientet e Vlora Fish SHPK, e cila ka kapacitete te mjaftueshem ambalazhuese aktuale per te siguruar paketimin e duhur dhe te sigurt per rritjen e metejshme te sasise kapacitetet prodhuese te Bello-Tris SHPK.

Per ambalazhimin dhe nxjerrjen e tij ne treg perdoren arka plastike njepedorimshe te riciklueshme, nderkohe qe transporti kryhet nepermjet mjeteve frigoriferike qe disponon kompania.


Ortofoto te vendodhjes se siperfaqes ne vleresim



Harta topografike e rajonit. Nomenklatura e Hartës në shkallë 1:10000 (K-34-123-D-d-3)



PLANVENDOSJA FERMES "BELLO TRISS" SH.P.K AKUAKULTURE DETARE - KARABURUN VLORE



▪ **Permbledhja ne gjuhe jo-teknike**

Mjedisi eshte gjithmone i prekur nga veprimtarite e ndryshme qe ushtrohen ne te, por ndikimi mund te jete i ndryshem, kjo eshte e lidhur ngushte me vete llojin e veprimtarise e cila mund te kete impakt te drejtperdrejte, te terthorte, te rendesishem apo mesatar i pranueshem.

Nje nga objektivat e ketij raporti eshte identifikimi i ndikimeve te mundshme qe mund te shkaktohen ne mjedis nga ky aktivitet ne teresi. Identifikimi i ndikimeve te mundshme ne mjedisin e kesaj zone do te vleresohen ne njerren prej fazave kryesore; faza e operimit.

Nuk marrin ne konsiderate fazen pas perfundimit se veprimtarise pasi ky projekt do te vazhdoj te jete i tille dhe pas shume kohesh. Disa prej ndikimeve kryesore qe jane vleresuar si te mundshme jane paraqitur si me poshte.

Shkarkime ne uje

Aktiviteti zhvillohet ne brendesi te burimit ujqor ne Detin Jon, ne nje distance rreth 890m nga vija bregdetare. Aktiviteti perbehet nga disa kosha lundruer te diametrave te ndryshem te cilet qendrojne te zhytur nen uje, si rrjedhoje ndikimet me te rendesishme te ketij aktiviteti jane ne ujerat detare, vecanerisht ne tabanin e detit. Ndikimet jane te rendesishme persa i perkete demtimit te cilesise se ujerave bregdetare dhe gjallesave te egra te llojeve te ndryshme qe e kane kete zone si habitatin e tyre. Rritja e peshqve ne nje densitet te tille (rritje intensive), rrit perqendrimit e disa komponenteve organik ne mjedisin ujqor, vecanerisht shtresa qe depozitohet ne tabanin e detit. Kjo shkaktohet nga ndotja fekale e aktivitetit te peshqve (jashteqitje dhe urine). Elementet ndotes jane rritje te perqendrimit te ndotesve organike, por edhe njekoheisht per shkak te rritjes se perqendrimit te gjallesave ne kete pjese varferimi i ujerave nga oksigjeni i tretur dhe ulja e intensitetit te drites ne thellesi dhe ne fundin e detit. Perverc sa me siper, aplikimi i ushqimit koncentrat, mjekimi i peshqve ne rastet e semundjeve te ndryshme, apo edhe ngordhja e tyre per shkaqe te demtimit fizik, shkaqe natyrore, asfiksimi apo nga ndonje lloj semundje e ndryshme, jane nje burim ndotje per zonen. Efekte te tilla, shkaktojne edhe frekuentimin e zones nga gjallesa te tjera te botes nenujore, nder te cilat edhe grabitqare te ndryshem.

Rastet e ngordhjes masive te peshqve, shkaktojne ndotje serioze, por keto mundesi jane te rralla, kryesisht mund te shkaktohen nga ndotja e ujit nga faktore te jashtem, nga rastet aksidentale dhe te shkarkimit te ndotesve ne mjedisin ujqor, ose ne rastet e perhapjes se semundjeve te ndryshme.

Aktiviteti i mjeteve lundruer, nuk vleresohet te kete ndikime te rendesishme ne mjedisin e zones.

Emetimet ne ajer

Emetime ne ajer nga funksionimi i ketij aktiviteti nuk ka.

Aktiviteti zhvillohet ne brendesi te ujerave detare dhe nuk ka kontakte apo shkarkime ne ajer. Ndotja e ajrit mund te vije vetem si rrjedhoje e grumbullimit dhe hedhjes se peshqve te ngordhur dhe si rrjedhoje e tyre te perhapen aroma dhe ndotje bakteriale e zones. Nje mundesi e tille eshte teper e rralle per te ndodhur por, gjithesesi nuk perjashtohet. Peshqit mund te helmohen apo te asfiksohen edhe nga faktore te jashtem si derdhja e lendeve te ndryshme ne det, te tilla si hidrokarburet dhe lubrifikantet, kjo mund te ndodhe vetem ne rastet e avarive dhe aksidentet ne mjetet lundruer qe i transportojne ato, apo ne avari te ndryshme ne portet tregtare.

Shkarkimet ne toke

Ky aktivitet nuk ka ndikime ne toke. Nuk ka ndertime te objekteve, nuk ka ndertim infrastrukture, nuk ka prodhim te mbetjeve te ngurta, apo te lengeta, etj.

Zhurmat dhe vibrimet

Emetime te zhurmave apo te vibrimeve nga funksionimi i ketij aktiviteti nuk ka. Nuk ka procese te tilla. Motobarkat e sherbimit mirembajtes jane te zakonshme si cdo mjet tjetër lundruer per distanca te shkurtra, nuk shkaktojne zhurma te larta. Aktiviteti i mjeteve lundruese, mund te sjelle largimin e faunes se eger te zones.

Mbetjet e prodhuara

Mbetje te ngurta qe prodhohen nga aktiviteti njerezor, jane mbetjet e riciklueshme te aktivitetit te stafit, nga konsumi i perditshem ne objektet ne vijen bregdetare. Keto mbetje te ngurta si plastike, shishe qelqi, materiale letre, mbetje organike, etj transportohen ne qendrat e banuara ku depozitohen ne kontenieret e mbetjeve urbane te Njesise Vendore Bashkia Orikum.

Ndikime te tjera

Ndikimi ne mjedisin social ekonomik, nuk eshte me efekte negative, aktiviteti ndikon pozitivisht ne rritjen e punesimit, rritjen e te ardhurave te taksave vendore, te zgjerimit te bizneseve vendase dhe te prodhimit te brendshem bruto, ne rast te eksportit te peshkut apo te reduktimit te tij nga importi.

Ne afersi te kesaj zone nuk ka qendra te banuara, as infrastrukture te zhvilluar. Zona e banuar me e afert me projektin eshte qyteza e Orikumit.

Projekti nuk ndikon ne demtimin e bimesise se zones, as ne relievin apo strukturen gjeologjike te tokes. Nuk ndikohet ne rritjen apo uljen e temperaturave te ujit te detit.

▪ Konsultimet nderkufitare

Zona ku zhvillohet do te zhvillohet aktiviteti nuk ka nevojte ti nenshtrohet procesit te konsultimit nderkufitar.

Ky projekt nuk ndodhet prane kufirit shteteror. Duke qene ne nje distance te larget nga kufiri shteteror i ujerave nder-territoriale, ky aktivitet nuk vleresohet te preke zonat kufitare dhe si rrjedhoje edhe ndikimi i tij nuk shkakton demtim te mjedisit nderkufitar.

▪ Autoriteti vendimarrës për dhenien e aktit të miratimit të lejes së mjedisit, procedurat dhe afatet që ndiqen.

Autoriteti miratues eshte Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministri i Turizmit dhe Mjedisit firmos per miratimin apo refuzimin e aplikimit per tu pajisur me leje mjedisit te tipi B, me propozim nga Agjencia Kombetare e Mjedisit, e cila shqyrton dokumentacion e paraqitur nepermjet Qendres Kombetare te Biznesit.

▪ Adresën e akm-së, ku publiku mund të dërgojë komentet dhe sugjerimet e tij, me shkrim apo në formë elektronike, brenda 20 (njëzet) ditëve nga data e njoftimit.

Web: <https://akm.gov.al>

Poste elektronike Email:info@akm.gov.al

**Pregatiti Raportin e Permbledhjes ne Gjuhen Jo-Teknike
Ekspert Mjedisi (Nr.5097 Prot, Nr. Identifikues 556)**

Erjona Bajraktari

